

BURIMET HISTORIKE NËN KËNDVËSHTRIMIN E RILINDASVE DHE INTELEKTUALËVE SHQIPTARË

Rilindësit dhe intelektualët shqiptarë gjithmonë kanë mbështetur mendimin se një popull që nuk ka historinë e vet, “*zihet si i vdekur*”. Njëkohësisht, në këtë kohë, edhe qarqet politike dhe kulturore të Europës, kur po shihnin se rënia e Perandorisë Osmane ishte shumë e afërt, filluan ta rrisnin gjithnjë e më tepër interesin e tyre për kombet dhe kombësitë që ishin nën sundimin e saj. Ky interesim, veçanërisht për popujt e Ballkanit, ishte për territoret, por njëkohësisht edhe për gjuhën, historinë dhe kulturën e tyre. Udhëtarët, kronikanët, historianët, albanologët e shekullit XIX dhe të fillimeve të shekullit XX, me shënimet, me dokumentet e grumbulluara dhe publikimin e tyre, iu bënë të njohur qarqeve europiane, botën e jetës shqiptare. Këtë ndihmesë, rilindësit dhe intelektualët shqiptarë e çmuan dhe e vlerësuan shumë. Zef Jubani, një nga rilindësit shqiptarë, do të shkruante: “*Shqipëria, sot mundet me u thanë asht ba e njohun ne Evropën e qytetënueme dhe asht ba ndër të dijshtmit objekt studimesh shkencore*”¹. Por burimet dokumentare të grumbulluara deri në atë kohë dhe ato që do të krijoheshin me vonë, ishte e domosdoshme të përqendroheshin në një qendër të vetme. I vetmi vend që mund të siguronte jetëgjatësinë e tyre, ishte arkivi. Duke u mbështetur në të dhënat e deritanishme, idenë e rëndësisë së krijimit të arkivave nga rilindësit shqiptarë e ka theksuar Jeronim de Rada. Këtë mendim të shprehur prej tij, e gjejmë të shprehur në letrën e Dora d’ Istrias dërguar atij, më 14 nëntor 1866². Krahas problemeve të tjera të kohës, ajo thekson dhe problemin e mbrojtjes së vlerave dokumentare nga dëmtimi dhe zhdukja e faktorëve të ndryshëm. Në të shkruhet: “*...është e të njëjtit mendim me të (Jeronim de Radës – K.N.) për të krijuar në të katër vilajetet shqiptare institucione kulturore*”, të cilat për nga përmbajtja do të kryenin funksionet e arkiv-muzeut: kërkimin, ruajtjen dhe grumbullimin e monumenteve të kulturës, këngëve popullore dhe dorëshkrimeve.

1 Z. Jubani, *Vepra të zgjedhura*, përgatitur nga Jup Kastrati, Tiranë, 1963, f. 65.

2 AQSH i RSH-së, F. 24, d. 54/1, f. 107-108.

Letra e Dora d' Istrias shërbeu dhe si një thirrje që iu bë të gjithë rilindësve dhe intelektualëve shqiptarë për t'i kthyer sytë ndaj kësaj trashëgimie të pasur të kulturës shqiptare. Është kjo arsyeja që dy nga arkivat dhe bibliotekat më të mëdha në Shqipëri gjatë administrimit të Perandorisë Osmane, do të jenë ajo e familjes Vlora në Shqipërinë e Jugut dhe ajo e familjes së Bushatlinjve në Shqipërinë e Veriut. Rilindësit dhe intelektualët shqiptarë e përqendruan vëmendjen e tyre dhe në arkivat e vendeve të tjera. Me mjaft interes është dhe hulumtimi i shkrimtares së mirënjohur Dora d' Istria. Duke këmbëngulur në punën e saj për të gjetur dokumente në arkivat e ndryshme të Italisë, në Austri dhe në Gjermani, ajo do t'i shkruajë mikut të saj, Jeronim de Radës më 20 janar 1870 “... se në këto arkiva ka gjetur shumë dokumente , të cilat dëshmojnë lashtësinë e Shqipërisë”³. Gjatë vitit 1871, ajo bëri kërkime jo vetëm në arkivat e Venedikut, por edhe në arkivat e Vjenës dhe të Berlinit⁴. Kërkimet e saj tërhoqën edhe vëmendjen e opinionit shkencor të huaj. Gazeta belge “Independance”, më 11 maj të vitit 1868, ka botuar artikullin e korrespondentit të Laipcigut, ku, ndër të tjera, shkruan se: *kishte lexuar me kënaqësi në revistat e huaja, se Dora d' Istria, prej mjaft kohësh, ishte drejtuar nga Livorno në Venedik, që të bënte kërkime në arkivat e tij për të ndriçuar historinë e Shqipërisë së Veriut nën sundimin venedikas*.

Hulumtues të arkivave të Venedikut, të Italisë, Austrisë, Gjermanisë janë dhe Zef Jubani, Pal Zef Skiroi, Guliem Toci etj. Dora d' Istra shkruan: “...Zef Jubani është hulumtues i rregullt i dokumenteve për historinë e vendit të tij dhe e zhvillon këtë veprimtari me durim dhe këmbëngulje”⁵. Arkivat e Napolit tërhoqin interesimin e madh të Guliem Tocit. Veçanërisht, ai do të bëjë kërkime për zbulimin e dokumenteve, lidhur me fillimet e vazhdimësisë së emigracionit shqiptar në Itali gjatë periudhës së Gjergj Kastriot Skënderbeut. Këto dokumente, të zbuluara prej tij në arkivin e Napolit, dëshmojnë nga një raport i Drejtorisë së Arkivave të këtij qyteti, drejtuar Ministrisë së Brendshme, lidhur me dokumentet ekzistuese në atë arkiv, të cilat i përkisnin emigracionit shqiptar⁶. Gjithashtu, ndër të tjera, theksohet se, megjithëse dokumentet veneciane lidhur me zotërimin e provincave shqiptare ishin me mjaft interes, me shumë rëndësi historike ishte dhe kadastra e familjeve të Shkodrës⁷. Njëkohësisht, në vazhdim të

3 AqSH i RSH-së, F. 77, d. 221, f. 106-107.

4 Po aty, f. 109.

5 Po aty, d. 54/1, f.9.

6 AqSH i RSH-së, F. 23, d. 54/1, f. 236-237.

7 AqSH i RSH-së, F.77, d. 24/1, f. 106-107.

këtij raporti, theksohej se pyetjeve të kësaj ministrie rreth emigrimit të shqiptarëve, i japin përgjigje shënimet e pakta të shkruara në këtë letër. Tek ato dokumente është bazë, numri i 750 akteve veneciane, ndërmjet viteve 1345-1690. Regjistrimin e kishin vendosur në vitin 1874 në dokumentet e Institutit venecian, duke parë në këtë arkiv skedat origjinale⁸. Rezultat i kërkimeve të vazhdueshme në këto arkiva ka qenë edhe gjetja e disa dokumenteve, të cilat janë monumente të kulturës shqiptare. Në vitin 1740, Gjon Kazazi, kryepeshkop i Shkupit, gjatë një vizite në Romë, në arkivin e Propagandës së Fides, zbuloi dokumentin e parë të gjuhës shqipe, “Mesharin” e Gjon Buzukut. Ekzistenca e këtij dokumenti u la në harresë për shumë kohë⁹, derisa e zbuloi studiuesi i njohur arbëresh, Pal Skiroi, në vitin 1909, pas shumë kërkimesh në Bibliotekën e Vatikanit¹⁰. Ky rizbulim ishte një ngjarje shumë e rëndësishme për historinë e gjuhës shqipe. Pal Skiroi ka bërë kërkime dhe në arkivat e Venecias. Në këto arkiva, ai ka gjetur dokumente me mjaft vlerë për historinë e Shqipërisë. Gjergj Fishta, lidhur me këto gjurmime, në vitin 1907, e përgëzonte atë nga Shkodra për punën e madhe që kishte bërë. Ai i shkruante ndër të tjera se dokumentet që ai kishte gjetur në bibliotekat e Mbretëreshës së Deteve (Rexhina de Mari) i kishin tejkaluar të gjitha parashikimet e tyre¹¹. Duke vazhduar më poshtë letrën, ai thekson një dorëshkrim të kopjuar me laps, i cili nga sasia e faqeve formonte një volum të mirë¹².

Mjaft i pasur është dhe letërkëmbimi i atdhetarëve arbëreshë, i cili ruhet në Arkivin Qendror Shtetëror të Republikës së Shqipërisë. Nga ky letërkëmbim është për t’u veçuar letërkëmbimi ndërmjet Jeronim de Radës dhe Dora d’ Istrias. Me vdekjen e rilindësve arbëreshë si Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Vincenzo Dorsa etj., letërkëmbimi dhe veprat e tyre në dorëshkrim mbetën të shpërndara andej-këndej, nëpër arkat e të afërmeve dhe të mbuluara nga pluhuri i harresës. Një punë plot pasion për grumbullimin e këtyre dorëshkrimeve ka bërë albanologu danez L. Hgelnslevi, i cili, sipas të dhënave të Dr. Gangalies, ka grumbulluar në Kopenhagen një fond arkivor të emërtuar “Dorëshkrimet arbëreshe”, me një volum prej 7500 faqesh¹³. Xhuzepina Knorr, poete austriake, ka mbajtur letërkëmbim të rregullt me Dora d’ Istrien. Në një letër që

8 Regjistër i kadastrës dhe i koncensioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417. Përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Tiranë, 1977.

9 Po aty.

10 AQSH i RSH-së, F. 77, d. 248, f. 24-25.

11 AQSH i RSH-së, F. 17, d. 62, f. 17.

12 Po aty.

13 A. Dhrima /E. Lafe, *Studime Filologjike*, Tiranë, 1974, nr. 4, f. 188.

Anselmo Lorekio i dërgon Jeronim de Radës, më 16 nëntor 1897, ndër të tjera i shkruan se Xhuzepina Knorri do t'i dhurojë Bibliotekës Kombëtare Shqiptare këtë korrespondencë¹⁴.

Kjo korrespondencë nuk ndodhet e plotë në AQSH-në e Shqipërisë. Në letrën e Xhuzepina Knorrit dërguar Nikolla Ivanajt, më 6 shkurt 1908, njoftohet se ajo ka testamentin e Jeronim de Radës të dhuruar prej tij¹⁵. Njëkohësisht, edhe letërkëmbimi i Jeronim de Radës që ndodhet në Arkivin Qendror, i cili përbëhet afërsisht nga 10 mijë letra, nuk është i plotë. Ky letërkëmbim, përbëhet kryesisht prej dokumenteve të dhuruara nga nipi i tij. Disa prej këtyre dorëshkrimeve, i kishte blerë në një ankand publik, sepse gjyshi i tij, Jeronim de Rada, i shtrënguar nga varfëria, ishte detyruar t'i linte peng¹⁶. Midis tyre ndodhej dhe vepra poetike “Këngët e Milosaos”. Letërkëmbimi tjetër, që nuk ndodhet në këtë arkiv, është marrë nga Akademia e Italisë¹⁷. Dokumente të atdhetarëve arbëreshë ka ruajtur dhe Guliem Toci. Ai, në një letër që i dërgon Jeronim de Radës, i shkruan se pranë vetes kishte një arkiv të tërë shqiptar dhe shumë vepra të tjera. Ndërmjet tyre, ndodheshin edhe disa letra lidhur me një histori të gjerë të Shqipërisë deri në periudhën e Rilindjes, me autor Dh. Agostino¹⁸. Përveç njoftimeve që jepte, ai i premtojte se nuk do t'i ndërpriste kërkimet, ditën dhe natën, për të gjetur bibliotekën dhe arkivin e tij të pasur¹⁹ (të Dh. Agostinos – K. N.). Me interes për historinë e mendimit politik arbëresh dhe gjithë lëvizjen kombëtare, do të ishte gjetja e letërkëmbimit të Dh. Kamardës. Dokumentet, të cilat ndodhen në Arkivin Qendror të Shqipërisë, në krahasim me të dhënat që na jep një inventar prej 30 fletësh²⁰, i cili përmban të renditura në formën e një katalogu, letrat drejtuar atij nga shokët dhe miqtë gjatë viteve 1841-1903, janë në një numër shumë të vogël. Duhet përmendur dy letra të Abdyl Frashërit, njëra dërguar më 18 gusht 1876, dhe tjetra është dërguar më 23 mars 1879, të cilat do të ishin me mjaft vlerë, sepse i përkasin periudhës para dhe pas Lidhjes së Prizrenit. Arkivi i Abdyl Frashërit ka qenë mjaft i pasur, por një pjesë mendohet se ka humbur gjatë Luftës I Botërore. Përveç letërkëmbimit, arkivi i tij përmbante dhe kujtime të shkruara, gazeta e libra. Ndërmjet dorëshkrimeve të tij, të cilat mendohet se mund të kenë

14 AQSH i RSH-së, F. 24, d. 54/1, f. 195-196.

15 AQSH i RSH-së, F. 44, d. 21/1, f. 245-246.

16 AQSH i RSH-së, F. 24, d. 56, f. 15.

17 Po aty.

18 AQSH i RSH-së, F. 24, d. 54/2, f. 156-157.

19 Po aty.

20 AQSH i RSH-së, F. 65, d. 98, f. 1-30.

humbur, është vëllimi prej 300-400 faqesh me titull: “Prizren hatirati yahudzmanan jadigjori”²¹ (Kujtimet e Prizrenit ose dhurata nga burgu). Tjetër dorëshkrim është dorëshkrimi në greqisht, afërsisht 200 faqe, me format të madh, ku Abdyl Frashëri pasqyron bisedimet e tij si përfaqësues i Komitetit të Stambollit me delegacionin grek, për krijimin e një aleance shqiptaro-greke, gjatë viteve 1877-1880²². Me interes është dhe dorëshkrimi prej 150 faqesh, të cilin ia ka kushtuar historisë së vendlindjes së tij²³. Ndërmjet tyre, ndodhej dhe dorëshkrimi tjetër në gjuhën shqipe prej 30 faqesh mbi historinë e familjes së Dukollarëve në Frashër²⁴. Mbas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, këto dorëshkrime origjinale, së bashku me plot dokumente të tjera të Abdyl Frashërit mendohet se kanë ardhur në Shqipëri dhe janë vendosur në shtëpinë e bijës së tij, Eminesë, e cila banonte në Fier. Ato ruheshin në arka të veçanta, por gjatë Luftës I Botërore, në rrethanat e vështira që u krijuan, ato humbën²⁵. Me mjaft interes për studiuesit është dhe fondi arkivor i Sami Frashërit. Një ndihmesë të madhe në pasurimin e kësaj trashëgimie ka dhënë nipi i tij Emin Eri, i cili i ka dhuruar Arkivit Qendror të Shtetit të Republikës së Shqipërisë fotokopje të dorëshkrimeve të Sami Frashërit. Origjinalet ruhen në arkivin e familjes së tij në Stamboll. Me të drejtë, studiuesi i kësaj figure, Shaban Çollaku, pohon se nga pena e Samiut kanë dalë me mijëra e mijëra faqe²⁶. Ndërmjet dorëshkrimeve do të veçonim parathënien e përgatitur prej tij për veprën “Shahnameja” të poetit të madh persian, Firdesiut. Sami Frashëri, duke parë se “Shahnameja” ishte një vepër mjaft voluminoze me 60 mijë vargje, për t’u ardhur në ndihmë të gjithë atyre që kishin dëshirë ta kishin në bibliotekë dhe nxënësve për të mësuar gjuhën perse, përgatiti një vëllim të veçantë “Zubde-I Sahnme” (Përmbledhja e Shahnamesë). Dorëshkrimi i shkruar në turqishten e vjetër (osmanisht), përbëhet nga një radhor i vogël prej 95 faqesh dhe në 4 të tjerë, gjithsej 409 faqe. Orientalisti i njohur Zyber Hasan Bakiu (Kruja), lidhur me përgatitjen e përmbledhjes së “Shahnamesë” shkruan se në studimin e tij studiuesi turk A. S. Levent “Shemseddin Sami”, shihet data 1331, që përkon me vitin 1915. Me të drejtë, Zyber Hasan Bakiu (Kruja) nënvizon më poshtë, se Sami Frashëri ka ndërruar jetë në vitin 1904. Pra,

21 “Hylli i Dritës”, Shkodër, 1922, nr. 10, f. 405.

22 “Dituria”, Tiranë, 1928, nr. 9-11, f. 321.

23 “Dituria”, Tiranë, 1928, nr. 9-11, f. 322.

24 Po aty.

25 Po aty.

26 Sh. Çollaku, *Mendimi iluminist i Sami Frashërit*, Tiranë, 1986, f. 7.

viti i përmendur duhet të jetë 1313 (1895/1896)²⁷. Një nga arkivat më të pasura që ruhet në AQSH-në e Shqipërisë, në krahasim me fondet e tjera personale të rilindësve, është arkivi i Dr. Ibrahim Temos. Arkivi i tij është sjellë në Shqipëri, në vitin 1960, nga studiuesi Zija Shkodra. Deri në këtë vit, arkivi i lartpërmendur është ruajtur me një kujdes të jashtëzakonshëm nga bashkëshortja e tij, Nafije Temo, në Kostancë (Rumani). Arkivin e Dr. Ibrahim Temos e kishin kërkuar për ta marrë edhe qeveria rumune, turke dhe jugosllave, por Nafije Temo nuk ia kishte dhënë asnjërës prej tyre. Amanetin e bashkëshortit nuk e shiste me para²⁸. Dr. Ibrahim Temo, përpara se të ndërronte jetë, kishte lënë një testament, nëpërmjet të cilit kërkonte realizimin e dy dëshirave. Njëra dëshirë ishte që, kur të ndërronte jetë, të mbulohej me flamurin kombëtar shqiptar dhe eshtrat të varroseshin në Shqipëri, në një vend buzë liqenit të Ohrit. Dëshira e dytë ishte që arkivi i tij t'i dorëzohej qeverisë shqiptare²⁹. Duke u mbështetur në kujtimet e bashkëshortes, ai e kishte sistemuar vetë arkivin³⁰. Arkivi i Dr. Ibrahim Temos është një burim mjaft i pasur për studimin e Lëvizjes kombëtare shqiptare, veçanërisht për lëvizjen xhonturke³¹. Dorëshkrime të tjera origjinale, të cilat mbajnë nënshkrimin e Dr. Ibrahim Temos, mund të ndodhen në arkivat e Stambollit dhe në arkivat dhe bibliotekat e Gjermanisë, sepse ai ka pasur një letërkëmbim të vazhdueshëm me orientalistin gjerman, Karl Sushain. Gjatë këtij letërkëmbimi, ai i ka dërguar Karl Sushainit dhe dokumente lidhur me jetën dhe veprimtarinë e vëllezërve Frashëri: Abdylit, Samiut dhe Naim Frashërit, figura për të cilat orientalisti gjerman kishte filluar të ndërmernte studime rreth jetës dhe veprimtarisë së tyre. Përpyekjet e pareshtura të Sofokli Capit në Egjipt kanë pasuruar fondet arkivore të Andon Zako Çajupit, Filip Shirokës dhe Thimi Mitkos, të cilat ndodhen në AQSH-në e RSH-së. Arkivi i Thimi Mitkos

27 Z. Hasan Bakiu (Kruja), *Bibliografi e zgjeruar e veprave të Sami Frashërit*, Tiranë, 1982, f. 239.

28 Z. Shkodra, *Dr. Ibrahim Temo, patriot i shquar në mërgim i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1865-1945)*, kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor të organizuar më 19 gusht 1995, në Strugë, me rastin e 130 – vjetorit të lindjes dhe 50-vjetorit të vdekjes, f. 3.

29 Po aty.

30 Po aty, f. 4.

31 Fondi arkivor i Dr. Temos është shfrytëzuar nga një numër i madh studiuesish, si nga Shqipëria, ashtu dhe nga Turqia dhe vende të tjera. Ndërmjet tyre mund të përmendim akademikun, Prof. Dr. Kristaq Priftin, dhe studiuesin turk, Prof. Dr. Shukru Hanioglu, pranë Universitetit të Princetontit (USA). Prof. Dr. Kristaq Prifti, duke u mbështetur kryesisht në dokumentet osmane që përmban arkivi i Dr. Ibrahim Temos, ka përgatitur monografitë: “*Dervish Hima*”, Tiranë, 1987, 1993 dhe “*Ibrahim Temo*”, Tiranë, 1996. Prof. Dr. Sukru Hanioglu, është një ndër të parët studiues të huaj, i cili ka shfrytëzuar arkivin e lartpërmendur në AQSH për përgatitjen e monografisë me titull: “*Doktor Abdullah Xheudet dhe periudha e tij*”, Stamboll, 1981.

përmban afërsisht 7000-8000 faqe dorëshkrime, ku vendin kryesor e zënë fjalorët. Ndërmjet tyre mund të përmendim “Fjalorin shqip-greqisht”, volumi i të cilit arrin në 3000 faqe. Në vitin 1887, Th. Mitko do t’i shkruante Nikolla Naços në Rumani, se “...në Athinë gruaja e të ndjerit Panajot Kupitorit, ka një fjalor dorëshkrim për ta shitur, që besoj se do t’iu pëlqejë”. Me gjithë pasurinë e madhe dokumentare të Thimi Mitkos, Andon Z. Çajupit, Jani Vretos, që ka ardhur në arkivat shqiptare, përsëri në arkivat shtetërore, në arkivat e shoqërive shqiptare dhe tek të afërmit e rilindësve shqiptarë me banim në qytete të ndryshme të Egjiptit, kërkimet duhen vazhduar. Në Fajum, Toubhar, Shibni – el Kom, Fashnje etj., ndodhen mjaft dokumente për këta atdhetarë. Ndihtesë të vyer në pasurimin e këtyre fondeve kanë dhënë veçanërisht Prof. Dr. Jorgo Bullo, Prof. Dr. Petrika Thëngjilli dhe një nga specialistët e njohur të arkivave shqiptare, Mihallaq Pela, të cilët me kërkimet e tyre të bëra në arkivat shtetërore dhe private në Egjipt, kanë bërë të mundur të gjejnë dhe të pasurojnë me dokumente të panjohura dhe me vlera të mëdha për historiografinë dhe gjuhësinë shqiptare. Sotir Kolea, ish-sekretari i shoqërisë “Vëllazëria e shqiptarëve” në Aleksandri, duke vlerësuar rëndësinë e dokumenteve që ndodheshin në Egjipt, më 21 dhjetor 1929, do t’i shkruajë Jani Vruhos mbi domosdoshmërinë e grumbullimit të këtyre dokumenteve. Ai, në vitin 1930, ndërmori vetë udhëtimin për në Egjipt, për të hulumtuar në arkivat personale të bashkëkohësve të tij dhe të arkivave të shoqërisë³². Gjatë këtyre kërkimeve, Milo Duci, Sofokli Capi, Stathi Konomi, Pjetër Shahini etj., i kanë dhuruar Sotir Koleas mjaft dokumente origjinale. Këto dokumente i përkasin arkivit të Jani Vruhos dhe shoqërisë “Vllaznia”. Një kujdes të posaçëm për grumbullimin e dokumenteve të Jani Vruhos ka treguar shoqëria “Tomorri” në Kajro³³. Kristo Vreto, në një letër, ndër të tjera, thekson se tri vite më parë, kur kishte qenë në Egjipt, kishte pasur gëzimin të bisedonte drejtpërdrejt me Jani Vruhon. Jani Vruho, gjatë kësaj bisede i kishte shprehur dëshirën që “...gjithë sa të shkruara me dorë, libra dhe gazeta të vjetra kishte mbledhur, do t’ia dhuronte Bibliotekës Kombëtare”³⁴. Ai ka pasur një letërkëmbim të gjerë edhe me Aleksandër Xhuvanin, Ismail Qemalin, Fan Nolin, Luigj Gurakuqin, Shahin Kolonjën, Josif Bagerin, Sotir Pecin, Mustafa Qullin etj. “Do të ishte një shërbesë e vërtetë për Kombin, – shkruan ndër të tjera Sotir Kolea, – dhe për kujtimin e veprimt të Vruhos, mbledhja me kujdes e

32 AQSH i RSH-së, F. 22, d. 7/1, f. 285-287.

33 AQSH i RSH-së, F. 54, d. 4, f. 174.

34 AQSH i RSH-së, F. 54, d. 66/1, f. 40.

*gjithë letrave, gazetave, librave që mund të ketë ruajtur*³⁵. Ai vinte në dukje, se “...ruante me kujdes çdo send që mund të shkruante në një fletore të gjuhës dake, e cila përmbante shumë fjalë nga gjuha shqipe”³⁶. Gjetja e kësaj fletoreje, e cila mund të jetë sot në duart e shqiptarëve që banojnë në Toubhar, ose tek anëtarët e ish-shoqërisë “Tomorri”, do të ishte një burim tjetër me vlerë në fushën e gjuhësisë. Një ndihmesë të madhe, krahas Kristo Dakos, Mustafa Krujës, motrave Qiriazit, për vlerësimin e dokumenteve si burime historike për historinë e Shqipërisë, ka dhënë edhe Mit’hat Frashëri. Në opinionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar, Mit’hat Frashëri, ka qenë dhe do të mbetet një dijetar e politikan me një horizont të gjerë intelektual. Ai, duke vlerësuar rolin e madh të arkivave, hulumtoi, grumbulloi dhe publikoi dokumente dhe libra në gjuhën shqipe dhe të huaj, brenda dhe jashtë vendit. Mit’hat Frashëri thekson se askush nuk mund të mohojë lashtësinë e shkrimeve, të librave dhe të studimeve shqiptare për një periudhë katërqind vjeçare. Dhe për të vërtetuar mendimin e tij, shtroi domosdoshmërinë e shfrytëzimit të arkivave, të bibliotekave dhe të ruajtjes së tyre për t’i trashëguar brez pas brezi për kohën e sotme dhe kohën e ardhme.³⁷

Në përgjithësi, pjesa më madhe e letërkëmbimit të rilindësve shqiptarë është e shkruar në gjuhën turqishte të vjetër, sepse kjo gjuhë në kohën që ata jetuan dhe vepruan ishte gjuhë zyrtare dhe së dyti, shumica e tyre kishin mbaruar shkollat, ku mësimet zhvilloheshin në këtë gjuhë, ose kjo gjuhë zinte vendin kryesor në programet mësimore të shkollave të Perandorisë Osmane. Njëkohësisht, ata ndjenin kënaqësi kur merrnin letrat e njëri-tjetrit dhe veçanërisht, kur ato shkruheshin në gjuhën shqipe, e cila ishte gjuha e tyre amtare. Por në letërkëmbimin e tyre nuk do të mungojnë dhe gjuhët e tjera, si frëngjisht, italisht, anglisht etj. Dervish Hima nuk ishte veçse 20 vjeç, kur i shkruante Dr. Ibrahim Temos, më 19 qershor 1896 se “...kishte mall të lexonte letrat e shokëve dhe të përpigëshin që të shkruanin e të lexonin në gjuhën tonë”³⁸ (gjuhën shqipe – K. N.). Letrat që përmbanin ngjarje të ndryshme politike, ata i kopjonin dhe ua dërgonin shokëve të tyre. Kështu, në letrën që mban datën 3 prill 1912, nga Nica (Francë), ku përshkruhen përgatitjet e kryengritjes së përgjithshme anti-osmane, në fillim të saj nënvizohet: “*Nga një letër që mora sot*³⁹. Kjo letër është

35 Po aty, f. 41.

36 Po aty.

37 Lumo Skëndo, “Dituria”, Tiranë, 1928, nr. 12, vol. III, f. 361.

38 AQSH i RSH-së, F. 19, d. 32/8, f. 90-91.

39 AQSH i RSH-së, F. 9, d. 16, f. 26.

kopjuar nga Aleksandër Xhuvani dhe i është dërguar Athanas Tashkos në Egjipt. Rilindësit shqiptarë, duke u angazhuar në një varg veprimtarish në dobi të çështjes kombëtare shqiptare, ishin gjithnjë në lëvizje. Është kjo arsyeja që ky letërkëmbim është shkruar nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Ai është shkruar nga Shkodra, Elbasani, Gjirokastra, Prizreni, Kolonja, Berati etj., por njëkohësisht edhe nga Stambolli, Kajro, Bukureshti, Sofja etj. Në përgjithësi, letërkëmbimi përmban në fund të letrës, emrin e plotë të autorit. Por, në disa raste, ky letërkëmbim është shkruar edhe me pseudonime të ndryshme. Rilindësit shqiptarë kanë përdorur pseudonimet e tyre, për shkak të ndjekjeve që u bëheshin atyre nga qarqet qeveritare osmane, serbo-malazeze, greke dhe konsullata të tjera të huaja që ndodheshin në Shqipëri. Nikolla Naço ia dërgonte kryesisht Dr. Ibrahim Temos letrat me pseudonimin “Rob i Kombit”⁴⁰, Milo Duci i shkruante letrat me pseudonimin “Lulo Malësori”⁴¹. Dervish Hima, në letrën dërguar Dr. Ibrahim Temos, më 19 qershor 1896, shkruante: *“Ekipit që doli për inspektim në Rumeli gjatë javëve të kaluara, i shkrova një promemorie shumë të fortë me nënshkrimin “Korrespondenti i posaçëm”*⁴². Një vend të rëndësishëm në fondet arkivore të rilindësve zënë dhe thirrjet, memorandumet dhe protestat e tyre drejtuar Fuqive të Mëdha. Ky lloj dokumentacioni hedh dritë lidhur me programin politik të lëvizjes kombëtare shqiptare dhe pasqyron mendimin përparimtar të kohës. Memorandumet, thirrjet dhe protestat, të cilat ruhen në AQSH-në e RSH-së, u përkasin viteve 1878-1912. Numrin më të madh të tyre e zënë memorandumet e popullsisë së krahinave të ndryshme shqiptare drejtuar Fuqive të Mëdha për mbrojtjen e tërësisë territoriale shqiptare nga synimet lakmuese të shteteve fqinje⁴³. Rilindësit shqiptarë për t’ia bërë të njohur opinionit europian e botëror të drejtat legjitime të kombit shqiptar, këto memorandume i botuan dhe në faqet e gazetave dhe të revistave, të cilat botoheshin në gjuhën shqipe dhe të huaj, jashtë vendit. Ndër këto gazeta, mund të përmendim: “Zëri i Shqipërisë” (Athinë), “Shqipëria” (Bukuresht), “Kalendari Kombiar” dhe “Drita” (Sofje), “Albania” (Romë), “Kombi” (Boston), “Bashkimi i Kombit” (Manastir), “Liria” (Selanik) etj. Në arkivat e atdhetarëve shqiptarë është ruajtur dhe një lloj dokumentacioni me mjaft vlerë, fotografia. Fotografitë si dëshmi historike të veprimtarisë së tyre plotësojnë epistolarin dhe në mungesë të

40 AQSH i RSH-së, F. 19, d. 32/6, f. 285.

41 “Drita”, Sofje, 31 gusht 1906, nr. 83.

42 AQSH i RSH-së, F. 19, d. 32/2, f. 5-6.

43 AQSH i RSH-së, F. 45, d. 4, f. 29.

dokumenteve ndriçojnë aspekte të ndryshme të ngjarjeve historike. Arkiv me vlera të veçanta për studiuesit është fototeka e Kel Marubit (Shkodër), e vëllezërve “Manaqi” (Manastir), Vani Burdës dhe Zografit në Korçë⁴⁴. Këta fotografë me aparatit e tyre fotografik kanë ndjekur hap pas hapi procesin e zhvillimit historik të vendit. Njëkohësisht, të udhëhequr edhe nga ndjenja e patriotizmit, kanë treguar kujdes të posaçëm për ruajtjen e tyre. Ky kujdes i madh i tyre ka sjellë për rrjedhojë edhe ruajtjen deri në ditët tona të një numri të madh fotografish, të cilat ndriçojnë aspekte dhe personalitete të ndryshme të kohës. Kështu, në arkivin mjaft të pasur të fototekës së Kel Marubit, studiuesi do të gjejë fotografi për veprimtarinë e atdhetarëve dhe për veprimtarinë e gjithanshme të Lidhjes së Prizrenit, shtëpinë e qendrës së saj në Shkodër, veçanërisht lidhur me veprimet luftarake gjatë viteve të ekzistencës së saj. Në arkivin e fototekës “Manaqi” ndodhen veçanërisht fotografi për krijimin dhe veprimtarinë e klubit “Bashkimi”, në Manastir. Ndërsa në objektivin e aparatit fotografik të Vani Burdës janë fiksuar shoqëritë shqiptare në Rumani dhe protrete atdhetarësh të tyre, si Aleksandër S. Drenova, Eftimi Zisi, Pandeli Cale, Llambi Bibli, Ndoc Koliqi, Filip Gjoka etj. Në vitin 1909, Dr. G. Patsch i kërkon Kel Marubit koleksion fotografish me pamje nga natyra për Institutin Ballkanologjik të Sarajevës⁴⁵. Etnografja dhe publicistja angleze, Edit Durham, të cilën e ka tërhequr gjithmonë historia dhe kultura shqiptare, më 5 shtator 1912, i shkruante atdhetarit Kel Marubi nga Mali i Zi, se po i dërgonte një çek për filmat që kishte marrë prej tij⁴⁶. Këto filma sot mund të ndodhen në muzeun Bankfield në Halifaks (Angli), sepse këtu ajo ka depozituar dhe një sërë objektesh etnografike shqiptare të mbledhura gjatë qëndrimit të saj në Shqipërinë e Veriut. Në arkivat personale të rilindësve janë ruajtur me kujdes të madh letërkëmbimi, veprat origjinale, dokumentet e grumbulluara dhe gazetat e kohës, të cilat kishin lidhje me ngjarje historike të Shqipërisë. Vendruajtje për dokumentet u bënë dhomat e shtëpive, hoteleve, ndërtesave dhe lokaleve ku banonin, punonin dhe zhvillonin veprimtarinë atdhetare rilindësit dhe intelektualët shqiptarë. Një kujdes të vazhdueshëm në ruajtjen e dokumenteve kanë treguar Dr. Ibrahim Temo, Kostandin Kristoforidhi, Kristo Dako, Lef Nosi, Mit’hat Frashëri, Syrja Vlora etj. Për rrjedhojë, fondet e tyre arkivore janë ndër fondet më të pasura që ruhen në AQSH-në e RSH-së. Arkivi

44 Arkivat e këtyre fondeve me fotografi ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit të Republikës së Shqipërisë.

45 AQSH i RSH-së, F. 580, d. 11, f. 6-7.

46 Po aty, f. 8.

i Dr. Ibrahim Temos ka tërhequr vëmendjen e studiuesve shqiptarë dhe të huaj, të cilët do t'i drejtoheshin atij sa herë që e ndjenin nevojën për përgatitjen e studimeve që kryenin. Ata do t'i kërkojnë që t'i ndihmojë me materiale, dokumente, fotografi dhe gazeta. Mes tyre mund të përmendim studiuesin turk Taip Nazifi për kryerjen e studimit të tij lidhur me lëvizjen xhonturke⁴⁷. Kurse Lef Nosi, edhe ai i pajisur me një kulturë të gjerë, është një ndër personalitetet më të njohura shqiptare për grumbullimin dhe ruajtjen e dokumenteve, të cilat i përkisnin historisë së kombit shqiptar. Ai do të gjurmojë edhe dokumente në fushën e folklorit, etnografisë, koleksione të rralla arkeologjike, kodike, kopjet e regjistrave të gjykatës së shtetit të Elbasanit etj. Fondi personal i Lef Nosit përmban dokumente me një shtirje të gjatë kohore nga viti 1603-1944. Do të duheshin vëllime të tëra për të botuar letërkëmbimin dhe gjithë pasurinë e tij dokumentare, që ai i ka lënë trashëgimisë së kulturës sonë kombëtare⁴⁸. Një kujdes të posaçëm ruajtjes së dokumenteve, i ka kushtuar gjatë gjithë jetës së tij dhe Syrja Vlora. Ai i ka parë ato si një burim kryesor të dorës së parë në shkrimin e historisë së kombit shqiptar, duke theksuar se çdo komb krijon për veten e tij një gjendje madhështie ose të kundërtën e saj, duke ditur historinë e së kaluarës.⁴⁹

Syrja Vlora kërkon që ngjarjet e mësipërme duke i analizuar përmes një kriteri shkencor, duhet t'i ndajmë në periudha dhe epoka, t'i japim historisë sonë një trajtë shkencore, të studiojmë veprat e huaja, të cilat janë shkruar për shqiptarët, t'i mbledhim ato sa të jetë e mundur, veshjet që i përkasin së shkuarës, veglat shtëpiake, bujqësore dhe luftarake dhe të sjellim në vendin tonë kopje të tablove me pamje nga Shqipëria, të cilat ndodhen në muzetë e Europës. Si fillim të punës, Syrja Vlora kërkoi grumbullimin e të gjitha veprave dhe dokumenteve, të cilat lidhen me historinë e Shqipërisë dhe përkthimin e tyre, duke përgatitur në këtë mënyrë, burimin kryesor për të shkruar në të ardhmen historinë nga një komision historianësh. Historianët do të emëroheshin dhe financoheshin, sipas tij, pjesërisht nga shteti, d.m.th. nga Ministria e Arsimit, dhe pjesërisht nga të ardhurat e vakëfeve që ndodheshin në çdo krahinë të Shqipërisë. Ai, gjithashtu kërkon që qeveria duhet të marrë nismën për të ngritur një muze që t'i përshtatet kohës, për të vendosur dhe ekspozuar veprat kombëtare, të cilat

47 AQSH i RSH-së, F. 19, d. 32/9, f. 26-27.

48 AQSH i RSH-së, F. 32, d. 6, 8, 12, 29, 106, 108, 129, 137.

49 *Syrja Vlora – Kujtime nga fundi i sundimit osman në Lufitën e Vlorës*, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Përgatitur nga Marenglen Verli dhe Ledia Dushku, Tiranë, 2013, f. 14.

do të mblidhen brenda dhe jashtë vendit. “Në shumë vende, – thekson Syrja Vlora, – ndodhen plot vepra të bukura të së shkuarës. Rreth këtyre antikave të bukura duhet të bëhen kërkime shkencore dhe gërmime arkeologjike. Këto do të formojnë natyrisht, burimin më me rëndësi të historisë sonë. Këto vepra, që ndodhen në këto vende të famshme, janë dëmtuar madje me qëllim që të nxirren thjesht gurë”. Më tej, Syrja Vlora kërkon ngritjen e një muzeu, të cilin e shikon si një shenjë të përparimit, udhëheqës të sotmes dhe të ardhmes, ushqim për shpirtin, shkak i lavdërimit dhe i lartësimit. Dhe, mbi të gjitha, ai kërkon hartimin e një ligji të posaçëm për të ruajtur këto objekte të vjetra, që janë një pasuri e drejtpërdrejtë e popullit dhe e vendit, për të mos rënë në duart e të huajve⁵⁰. Syrja Vlora, për realizimin e studimeve të tij, ka bërë kërkime të shumta në disa arkiva dhe biblioteka të Europës. Për çdo libër dhe dokument që gjente në këto biblioteka dhe arkiva, lidhur me historinë e Shqipërisë, mbante shënime të hollësishme, duke u vënë dhe një numër përkatës. Vetëm për ngjarjet e ndodhura në Shqipëri, nga 13 gushti i vitit 1912 deri në tetor të vitit 1913, Syrja Vlora ka regjistruar 750 dosje, të cilat përmbanin dokumente me shumë rëndësi për historinë dhe kulturën e territoreve shqiptare. Ai jep një informacion me vlerë dhe për grumbullimin e 2000 vOLUMEVE historike, të grumbulluara nga Aladro Kastrioti, i cili synonte trashëgiminë e fronit dhe të kurorës së Shqipërisë, si pasardhës i Skënderbeut. Syrja Vlora arrin në konkluzionin, ashtu si Mit’hat Frashëri, se

“...duhet të shqyrtojmë të gjitha dokumentet historike që ndodhen ndër bibliotekat kombëtare të Stambollit, të Korfuzit, Napolit dhe të Raguzës, sidomos ato që janë në arkivat e Vjenës. Kështu duhen vënë themelet e historisë sonë kombëtare.

Arkivi i Syrja Vlorës përmban dokumente me një shtrirje të gjatë kohore, 1741 – 1944. Një grup më vete formon letërkëmbimi i tij me Abdi Toptanin, Aqif Pashën, Esat Pashën, Dervish Himën, Fan Nolin⁵¹ etj. Me interes janë dhe studimet me karakter politik, historik, ekonomik e kulturor⁵². Rilindësit shqiptarë për ruajtjen e dokumenteve duhet të përballonin edhe pengesa e vështirësi të shumta, si ndjekjet, burgimet dhe persekutimet e pushtuesit osman. Nuçi Naçi, në vitet 1899-1900, mori të gjitha masat për të fshehur letërkëmbimin që kishte me shqiptarët brenda e jashtë vendit dhe çdo dokument që mund të ngjallte dyshim

50 Po aty, f. 204.

51 AQSH i RSH-së, F. 56, d. 26, 27, 28, 30, 102, 103.

52 AQSH i RSH-së, F.56, d. 8, 9, 11, 12.

te nëpunësit osmanë, të cilët kërkonin pretekst për të mbyllur shkollën shqipe në Korçë⁵³. Dyshe-menë e drejtorisë së shkollës e bëri arkiv të këtyre dokumenteve.⁵⁴ Dy ditë përpara se ta kapnin forcat policore të sundimit osman, atij i kishin ardhur dy letra nga Manastiri për mënyrën e mbajtjes së shkollës shqipe të hapur në vitin 1887. Këto dy letra i kishte futur në kutinë e duhanit, ku nuk u shkonte ndërmend forcave policore osmane t'i gjenin ato. Për të mos rënë në duart e tyre, këto letra i dogji në burg, në një vend të fshehtë⁵⁵. Arkiv të pasur ka pasur në shtëpinë e tij në Tiranë edhe Refik Toptani. Atij, gjatë kontrollit që iu bë nga autoritetet osmane në vitin 1910, përveç librit të Sami Frashërit me titull "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet", i janë gjetur edhe "një shumicë fletorësh të dëmshme", nëpërmjet të cilave hidhej dritë se "...të përmendurit kanë punuar fshehurazi për formimin e një shoqërie nën emrin Bashkimi"⁵⁶. Letrat e Refik Toptanit ishin shkruar nga sekretari i tij, Mehmet Fortuzi, të cilin forcat osmane e kapën gjatë këtij kontrolli⁵⁷. Këto dokumente ose mund të ndodhen sot në arkivat e Stambollit, ose mund të jenë asgjësuar në atë kohë.

53 H. Myzyri, *Nuçi Naçi*, Tiranë, 1968, f. 47.

54 "Dituria", vol. 5, Tiranë, 1 mars 1927, f. 166 – 167.

55 Po aty.

56 AQSH i RSH-së, F. 143, d. 928, f. 1 – 2.

57 Po aty.